

INFOSOFT SD SHPK

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

1. Të përgjithshme

Shoqëria "Infosoft Software Developer" sh.p.k është krijuar më 20.01.2003 me NIPT K31418036C.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat.

"INFOSOFT SD" sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
Kapitali i shoqërisë "INFOSOFT SD" sh.p.k. është 33,500,000 lekë. Ortakë të shoqërisë janë z.Illir TONA 60% dhe z.Gentian QIRJAZI 40%.
Administrator i shoqërisë është Z. Ilir TONA.

Objekti i veprimtarisë: Prodhim dhe shitje Software (programe), dizajnim dhe zhvillim, projektim i detajuar i software dhe bazes se te dheneve, analize, zhvillim, programim (kodim), integrim i komponenteve, trajnime, instalime, konsulenca, implementime dhe te tjera ndihmese ne kete fushë, ndjekje te proceseve, kolaudim, korrigjim, deri ne produktin perfundimtar duke realizuar zgjidhje informatike, plotesim i sistemit informatik me elementet e sigurise, privatesise etj, zhvillim ne kohe te ndryshme, duke garantuar upgrade te sistemit per te realizuar komunikime me versione te ndryshme te sistemit informatik. Blerje shitje Hardware, kompjutera, aksesore dhe pjese te tyre, import eksport kompjutera, hardware dhe aksesore te tjere, instalim e mirmbajtje te tyre.

Numri mesatar i punonjësve gjatë vitit 2019 ka qënë 35.

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Mustafa Matohiti, Tiranë.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata për pajtueshmëri

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në LEK e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

3. Politikat kontabël të rëndësishme

(a) Transaksionet ne monedha të huaja

Transaksionet në monedhat e huaja janë përkthyer me kursin e kombimit të datës së transaksionit. Aktivitet monetare në monedha të huaja janë përkthyer në LEK me kursin në ditën e mbylljes së bilancit. Diferencat e konvertimit si pasojë e përkthimit të monedhave të huaja në Lekë janë përfshirë në fitim humbje. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj janë raportuar me kursin historik të monedhës së huaj në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj të vlerësuara me vlerën e drejtë janë përkthyer në LEK me kursin e monedhës së huaj në datën e bilancit.



INFOSOFT SD SHPK

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

Kursct e këmbimit janë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
1 EUR	121.77	123.42
1 USD	108.64	107.82

(b) Instrumentat financiarë

Shoqëria zotëron instrumenta financiarë që përfshijnë llogari klientesh, mjete monetare, dhe llogari të tjera për tu paguar apo për tu arkëtuar me karakter tregetar. Llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat, njihen fillimisht në datën e krijimit të tyre. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë (përfshi dhe ata me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve), njihen fillimisht në datën kur shoqëria bëhet palë kontraktuale e një instrumenti.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat në banka, investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi më pak se tre muaj të cilat nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Ato vlerësohen me vlerën nominale.

Llogaritë e klientëve dhe llogari të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e klientëve dhe llogari të tjera të arkëtueshme janë vlerësuar me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Llogaritë e furnitoreve dhe të tjera llogari të pagueshme

Llogaritë e furnitoreve dhe të tjera llogari të pagueshme janë vlerësuar me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Të tjera

Instrumenta të tjera financiare janë vlerësuar me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

(c) Inventarët

Inventarët maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre shoqëria vlerëson inventarin me vlerën më të ulët mes koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e mbylljes së bilancit. Shuma e zhvlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ka faktorë objektivë që tregojnë që inventarët janë zhvlerësuar. Metoda e vlerësimit është kosto mesatare.

(d) Aktivtë Afatgjata Materiale**(i) Njohja dhe matja**

Aktivtë Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston minus amortizimin e akumuluar sipas SKK 5 "Aktivtë AA Materiale dhe AA Jomateriale".



(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

(ii) Kostot vijuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese përbërëse të një prej aktiveve materiale afatgjata, njihet në vlerën e mbartur të aktivit, nëse është e mundur që Shoqëria do të ketë përfitime ekonomike të ardhshme nga ky veprim dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera e mbartur e pjesës së zëvendësuar rregjistrohet. Kostot e shërbimeve të përditëshme të aktiveve material afatgjata njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi (Amortizimi)

Zhvlerësimi AA Materiale dhe AA Jomateriale është llogaritur sipas metodës zbritëse duke përdorur normat fiskale të amortizimit sipas tabelës së mëposhtme:

	Norma e amortizimit
Instalime teknike specifike	20%
Mjete transporti	20%
Mobilje, pajisje zyre dhe te tjera	20%
Pajisje informatike	25%
Software Informatike	25%

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga dëmtimi ose dalja jashtë përdorimit e një aseti, përcaktohen nga diferenca ndërmjet vlerës së përfutur të realizuar dhe vlerës së mbetur kontabël të asetit dhe kjo vlerë njihet si e ardhur apo shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(e) Zhvlerësimi i aktiveve

(i) Aktivet financiare

Aktivët financiarë vlerësohen në çdo datë të raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për zhvlerësim. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse ka evidencë objektive që tregojnë se ka ndodhur një ngjarje humbjeje pas njohjes fillestare të aktivit që ndikon negativisht fluksin e ardhshme monetare të vlerësuar për këtë aktiv dhe nëse këto fluks mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferenca mes vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të fluksëve të ardhshme monetare të skontuara me interesin efektiv. Humbjet njihen si në llogaritë e fitim/humbjeve ashtu dhe në llogaritë e zbritjeve të arkëtueshmeve.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen individualisht për zhvlerësim. Pjesa tjetër e aktiveve grupohen sipas karakteristikave të riskut të kreditë dhe vlerësohen në grup. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në llogaritë e fitim/humbjes. Kur një ngjarje e mëposhtme ul shumën e njohur të humbjes nga zhvlerësimi, ulja e humbjes nga zhvlerësimi rimerrret në llogaritë e fitim/humbjes.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare me përjashtim të taksave të shtyra, rishikohet në çdo periudhë raportuese për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikator për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë indikacion i tillë, atëherë bëhet vlerësimi i shumës së rikuperueshme të aktivit. Në këtë mënyrë një humbje nga zhvlerësimi regjistrohet nëse vlera e mbartur në kontabilitet e këtij aseti e

(Signature)



INFOSOFT SD SHPK

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

tejkalon vlerën e rikuperueshme. Këto humbje nga zhvlerësimi pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi përcaktohet si më e madhja midis vlerës së tij të përdorimit dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në përcaktimin e vlerës së përdorimit, parashikimi i flukseve monetare skontohehet për të aritur tek vlera aktuale duke përdorur normat e skontimit përpara taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe të rreziqeve specifike të këtij aktivi.

Humbjet nga zhvlerësimi të regjistruara në periudhat e mëparshme rivlerësohen në çdo periudhë raportuese për të parë ndonjë indikator nëse këto humbje janë zvogëluar ose nuk ekzistojnë më. Një humbje nga zhvlerësimi rishikohet në se ka ndonjë ndryshim të parashikimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Një humbje nga rivlerësimi rishikohet deri në atë masë sa vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbartur neto nga amortizimi, nëse kjo humbje nuk do të ishte regjistruar fare.

(f) Përfitimet e punonjësve

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj, për të kontribuar në skemat e pensionit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kostoja e përballuar në emër të Shoqërisë regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ashtu siç ndodhin.

(g) Provizionet për rreziqe

Provizionet për rreziqe pranohen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor apo të pranuar tërthorazi), si rezultat i ndodhive në të kaluarën dhe ka gjasa që përmbushja e këtyre detyrimeve kërkon sakrificimin e burimeve në pronësi të Shoqërisë të cilat do të sillnin përfitime ekonomike në të ardhmen, dhe Shoqëria ka mundësi të përcaktojë besueshëm vlerën e këtyre rreziqeve. Provizionet përcaktohen duke bërë skontimin e shumave të parashikuara për tu paguar në të ardhmen me normat e skontimit para tatimit që reflektojnë vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe të rreziqeve specifike të këtij detyrimi.

(h) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe kryerja e shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të kompanisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet.

(i) Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet janë njohur mbi bazën e të drejtave të konstatuara. Të ardhurat dhe shpenzimet janë njohur sipas metodës së konstatimit të të drejtave dhe detyrimeve. Shpenzimet janë njohur në vitin ushtrimor si dhe të ardhurat që lidhen me to (procesi i përputhjes së të ardhurave me shpenzimet).

(j) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë bankare, dhe përfitimet nga diferencat e këmbimit. Interesat njihen ashtu siç përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga diferencat e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kursat e këmbimit raportohen në baza neto.



INFOSOFT SD SHPK

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

(k) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin paraqitet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përjashtuar rastet kur lidhet me zërat e kapitalit e për rrjedhim paraqitet në kapital.

Tatimi është tatimi i parashikuar për tu paguar, i përlogaritur mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi (5% dhe 15%) në datën e bilancit si dhe çdo korrigjim të tatimit të pagueshëm të periudhave të mëparshme. Aktiviteti bazë i shoqërisë është prodhimi dhe zhvillimi i software-ve dhe norma tatimore për këtë aktivitet është 5%.

SHPJEGIME PËR ZËRAT KRYESORË TË PASQYRAVE FINANCIARE

4 Mjete Monetare

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Banka	92,465,764	69,623,682
Arka	335,309	152,129
Totali	92,801,073	69,775,811

5 Aktive te tjera financiare afatshkurta

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<i>Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit</i>	-	-
<i>Aksionet e veta</i>	-	-
<i>Te tjera Financiare</i>	-	-
Totali	0	0

6 Të drejta të arkëtueshme

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	28,526,259	27,218,469
<i>Provizione per faturat e klienteve</i>	(3,781,738)	(1,719,361)
<i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>	-	-
<i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	-	-
<i>Të tjera</i>	58,018	2,086,971
<i>Provizione per debitore te ndryshem</i>	-	-
<i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>	-	-
Totali	24,802,539	27,586,079

7 Inventarët

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	53,206	45,948
<i>Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte</i>	-	-
<i>Produkte të gatshme</i>	-	-
<i>Mallra</i>	1,458,579	1,289,522
<i>Aktive Biologjike</i>	-	-
<i>AAGJM të mbajtura për shitje</i>	-	-
<i>Parapagime për inventar</i>	-	-
Totali	1,511,785	1,335,470



8 Aktive Afatgjata Materiale dhe Jomateriale

	Toka	Ndertesa	Instalime teknike specifike	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje zyre	Pajisje informative	Te tjera AA Materiale	Totali Aktive Afatgjata Materiale		Totali Aktive Afatgjata Jomateriale	Totali Aktive Afatgjata
Me 31.12.2018											
Kosto	-	-	22,066,379	11,498,150	4,709,821	9,784,087	143,700	48,202,137	14,991,923	63,194,061	
Amortizimi i akumuluar	-	-	12,625,859	8,576,908	3,516,871	6,676,625	70,740	31,467,004	13,466,619	44,933,623	
Vlera kontabel neto	-	-	9,440,519	2,921,242	1,192,950	3,107,462	72,960	16,735,133	1,525,305	18,260,438	
Shtesa-Blerjet gjate vitit 2019					182,491	587,486		769,977	852,390	1,622,367	
Pakesime gjate vitit 2019											
Levizje shtesa											
Levizje pakesime											
Shtepzimitet e autorizimiti 2019		1,888,104		584,248	258,757	831,073	14,592	3,576,774	382,771	3,959,545	
Pakesime amortizimi 2019											
Levizje amortizimi per shtesa											
Levizje amortizimi per pakesime											
Me 31.12.2019											
Kosto	-	-	22,066,379	11,498,150	4,892,312	10,371,573	143,700	48,972,114	15,844,313	64,816,428	
Amortizimi i akumuluar	-	-	14,513,963	9,161,156	3,775,628	7,507,698	85,332	35,043,778	13,849,390	48,893,168	
Vlera kontabel neto	-	-	7,552,415	2,336,994	1,116,684	2,863,875	58,368	13,928,336	1,994,924	15,923,260	



[Handwritten signature]

INFOSOFT SD SHPK

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

11	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		
		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
	Shitje e shërbimeve software	104,733,618	84,576,166
	Shitje Hardware	7,145,068	11,398,645
	Shitje e shërbimeve tjera	320,706	233,369
	Totali	112,199,392	96,208,180
12	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		
		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
	Blerje /Shpenzime materjale	4,701,798	7,684,554
	Blerje /Shpenzime materjale të tjera	-	809,451
	Blerje /Shpenzime mallra, shërbime	606,665	160,264
	Totali	5,308,463	8,654,269
13	Të tjera shpenzime		
		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
	Blerje /Shpenzime të tjera	4,802,916	8,364,973
	Totali	4,802,916	8,364,973
14	Shpenzime të personelit		
		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
	Paga dhe shpërblime	26,353,614	23,783,835
	Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	4,391,406	3,896,777
	Totali	30,745,020	27,680,612
15	Shpenzime konsumi dhe amortizimi		
		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
	Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	3,959,545	4,722,331
	Zhvlerësimi aktiveve afatshkurtra	-	-
	Totali	3,959,545	4,722,331
16	Shpenzime të tjera shfrytëzimi		
		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
	Qira	2,004,000	2,004,000
	Mirëmbajtje dhe riparime	930,098	3,108,609
	Shpenzime energji, uje	675,198	483,057
	Shpenz për patenta, licensa dhe të ngjashme	244,200	349,616
	Shpenzime publiciteti, reklame	2,255,453	2,301,460
	Sigurime	145,126	349,428
	Udhetime dieta	7,582,259	4,564,700
	Shpenzime postare/telekomunikacioni	897,625	1,006,490
	Shpenz transporti	-	11,505
	Të tjera shërbime	177,719	164,820
	Shërbime bankare	103,512	89,703



INFOSOFT SD SHPK

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2019

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

Taksa, tarifa vendore	67,000	67,067
Tatime të tjera	4,029	21,475
Shpenz pritje, perfaqesime	66,250	27,390
Gjoha demshperblime	66	170,053
Shpenzime tjera	969,457	613,982
Totali	16,121,993	15,333,355
17 Të ardhura të tjera	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<i>Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	-	180,000
<i>Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata</i>	652	4,205
<i>Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme</i>	652	4,205
Totali	652	184,205
18 Shpenzime financiare	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme</i>	-	-
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>	661,831	2,835,629
Totali	661,831	2,835,629
19 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi/Humbja para tatimit	48,537,899	28,801,217
<i>Shpenzime të pa zbritshme</i>	-	170,053
Gjoha demshperblime	-	-
Shpenzime për pritje dhe perfaqesime	5,439,943	1,310,000
Shpenzime të panjohura	5,439,943	1,480,053
Totali	53,977,842	30,281,271
Fitimi tatimor	53,977,842	30,281,271
Humbje e mbartur		
Fitimi tatueshem neto	53,977,842	30,281,271
Tatimi mbi fitimin (15%)	302,801	451,370
Tatimi mbi fitimin (5%)	2,597,958	1,363,607
Shpenzime tatim fitimi	2,900,759	1,814,977
Fitimi/Humbja e vitit	45,637,140	26,986,240



[Handwritten signature]

INFOSOFT SD SHPK**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2019**

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

Te ardhurat dhe shpenzimet e realizuara nga aktiviteti i prodhimit dhe zhvillimit të software-ve për të cilat tatim fitimi është 5% paraqiten si më poshtë:

Te ardhura të realizuara nga software	104,734,270	84,576,166
Shpenzimet për software		
<i>Kosto e punës (Paga dhe sigurime shoqerore shendetesore)</i>	23,262,811	22,454,040
<i>Kosto e shërbimit</i>	24,496,672	28,207,686
<i>Shpenzime operative dhe të përgjithshme</i>	10,455,560	8,101,513
Total shpenzime	58,215,043	58,763,239
Fitimi	46,519,227	25,812,927
Shpenzime panjohura	5,439,943	1,459,208
Fitimi tatueshem	51,959,170	27,272,134
Tatimi mbi fitimin (5%)	2,597,958	1,363,607

20 Angazhime dhe pasiguri*-Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

-Detyrimet tatimore

Shoqëria nuk është kontrolluar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një kontroll i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

21 Ngjarje pas mbylljes së bilancit

Pas datës së mbylljes së bilancit nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme e cila kërkon rregullime të pasqyrave financiare, apo dhënien e shpjegimeve plotësuese për to.

ADMINISTRATORI**Ilir Tona**